



BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJ



MUAJI TETOR

PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet_e_tiranes

“Karakteristika të Stinës së Vjeshtës”



Çfarë duhet të dime për Vjeshtën?

- * Vjeshta është një nga katër stinët e bukura të vitit ku natyra merr një pamje përrallore.
- * Karakteristikë e stinës së vjeshtës është zverdhja e gjetheve dhe rënia e tyre në tokë.
- * Në vjeshtë, dita nis të bëhet më e shkurtër dhe nata vjen më shpejt.
- * Në vjeshtë, shumë kafshë fillojnë të përgatiten për stinën e dimrit duke mbledhur dhe ruajtur ushqimin nëpër fole dhe strofka.

Muaji Tetor – Tema Mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës
Grupi mix: 24-36 muaj

-
- * **Java I:** Karakteristikat e përgjithshme të stinës së vjeshtës
- * **Java II:** Njohja me elementët kryesorë të stinës së vjeshtës
- * **Java III:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së vjeshtës
- * **Java IV:** Veshja në vjeshtë





Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Karakteristikat e përgjithshme të stinës	Njohja me elementët kryesorë të stinës si: moti në vjeshtë, shiu, era.	Java I
Njohja me elementët kryesorë të stinës	Njohja me disa elementë kryesore si: dielli, qielli, shiu përmes punimeve të vizatimit.	Java II
Njohja e frutave dhe perimeve të stinës	Njohja e frutave, perimeve përmes demonstrimit të pëgatitjes së ushqimeve.	Java III
Veshja në vjeshtë	Si vishemi në vjeshtë? Ndryshimi nga veshjet e lehta të verës tek ato më të ngrohtat.	Java IV
Shënim:		
<ul style="list-style-type: none"> * Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët. * Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi. 		

Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

Tema e javës: Njohja me Karakteristika të Përgjithshme të Stinës





Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Karakteristikat kryesore të stinës së vjeshtës</p> 	<p>Shëtitje: Së bashku me fëmijët mblidhni gjethe/degëza peme (shoqëruar me numërimin e tyre, emërtoni ngjyrat e gjetheve etj).</p> <p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Gjatë aktivitetit në oborr tregojuni fëmijëve për shiun, erën, retë, rënien e gjetheve, qiellin në vjeshtë etj. (Ilustroni me figura nëse e zhvilloni aktivitetin në grup)</p> <p>Vjersha: “Vjeshta”</p> <p>Loja: “Pikturimi me gishta – mbi ngjyrat e vjeshtës”.</p> <p>Loja: “Roza- Rozina”</p>	<p>Manuali i Vjershave</p>  <p>Manuali i Lojrave</p>
E Martë	<p>Pasqyrimi i karakteristikave përmes vizatimit</p> 	<p>Ngjyrosje:Fëmijët ngjyrosin figurat e vizatuara më parë nga edukatoret si: forma të reve, të gjetheve etj.</p> <p>Aktivitet: Krijimi i një tabloje me temë “Vjeshta”. Në një karton lejojini fëmijët të ngjysin gjethet, retë, diellin, pemët, dhe elementët e tjerë e përgatitura më parë me letër ose plastelinë, për të krijuar natyrën në stinën e vjeshtës. Emërtojmë ngjyrat e gjetheve (e verdhë, kafe, e kuqe, e gjelbër etj.)</p> <p>Vjersha: “Vjeshta”.</p> <p>Loja: Domino me ngjyra.</p>	<p>MjeteDidaktike Manuali i Vjershave</p> 




<p>E Mërkurë</p>	<p>Ngjyrat e vjeshtës</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/pyet fëmijët mbi ngjyrat referuar punimeve të ditëve të mëparshme ose përmes ilustrimit të figurave të tjera (revista, punime që disponojnë në grup, etj).</p> <p>Vjersha: “Vjeshta”</p> <p>Loja: Formojmë gjethet me plastelinë. (përdorni plastelinë me ngjyrat e vjeshtës).</p> <p>Loja:Udhëzime me dy hapa. Jepuni fëmijëve disa udhëzime dyshe si: përplas duart dhe hidhu; duart te koka dhe kërcit gishtat etj.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Plastelinë.</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Pemët dhe gjethet në vjeshtë</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon dhe u demonstron fëmijëve përmes figurave ose materialeve të ndryshme karakteristikat e pemëve (mund të përdorni tablën e krijuar ditën e martë). Ajo i pyet fëmijët: Çfarë ngjyre janë gjethet? Çfarë forme kanë ato ? A janë njëlloj, etj ».</p> <p>Vjersha: “Vjeshta”</p> <p>Aktivitet me ngjitje : Ngjisim gjethet me ngjitës që pikon. (Krijojmë figura të ndryshme insektesh dhe kafshësh me gjethe).</p> <p>Lojra të lira: “Me formuese, me birila, puzzle etj”.</p> <p>Këngë lëvizore.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p>	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Vjeshta”</p> <p>Përrallë e lirë - ilustrim i figurave (përdorni librat që keni në grup).</p> <p>Loja: Treni.</p> <p>Loja: Domino me ngjyra.</p>	<p>Manuali i Vjershave Libra, revista</p>

Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

Tema e javës: Njohja me Elementët Kryesorë të Stinës





Ok Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Qielli & Dielli në vjeshtë 	Shëtitje: Gjatë aktivitetit në oborr me fëmijët tregoni për diellin, qiellin, eksplorojmë mjedisin përreth (ose nga dritarja). Edukatorja u tregon/pyet fëmijët: Si është dielli/qielli në vjeshtë? Çfarë ngjyre ka qielli sot? A ka re në qiell? etj. (ilustroni përmes punimeve me letër, librave, revistave. Ngjyrosje ose punë me plastelinë: “Dielli/Retë”(të ndarë në grupe) Përrallë e lirë - ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup). Lojë: Loja treni.	Manuali i Vjershave Libra, revista, plastelinë
E Martë	Ditë vjeshte me re dhe shi. 	Aktivitet krijues: Formojmë retë dhe shiun me mjete të ndryshme si letër, pambuk, plastelinë etj. Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve rreth qiellit/reve/shiut. Si janë ditët në vjeshtë? - Me re/me shi. Vjersha: “Shiu” Loja: “Bërja e vulave” (në formë reje/çadre). Këngë : ” Rosat notojnë në liqen”.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike



<p>E Mërkurë</p>	<p>Ditë shiu.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja u tregon fëmijëve për shiun, çadrat, pse i përdorim ato? Çfarë ngjyre ka çadra juaj/Me çfarë personazhi? Vjersha: “Shiu” Loja: “Ngjitësi që pikon dhe piktura me oriz dhe pambuk”(punimi i reve dhe shiut). Loja Loja me shami ose me karrige.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Çadra ime</p> 	<p>Aktivitet i improvizuar: “Kam dhe unë çadrën time” - Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që t’i pajisin fëmijët me çadra atë ditë – Fëmijët tregojnë / pyesin njëri-tjetrin për çadrën e tyre, duke u stimuluar nga edukatorja (numërojmë çadrat, emërtojmë ngjyrat e tyre, pëmendim konceptet më e madhe, më e vogël etj). Ngjyrosje: “Çadra- ngjyrosja e formave nga fëmijët të vizatuara më parë nga edukatorët. Vjersha: “Shiu”. Loja: Më e lehtë më e rëndë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p> 	<p>Vjersha: “Shiu” Përrallë e lirë - Ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup). Improvizim Një ditë me shi në çerdhe. Vishini fëmijët me mushama ose krijoni ato vetë me mjete të riciklueshme. Jepuni fëmijëve çadrat. Këngë lëvizore 2.</p>	<p>Manuali i Vjershave Libra.</p>

Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

Tema e javës: Frutat dhe Perimet e Stinës



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Njohja me frutat.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/demonstron fëmijëve përmes formave plastike, tablove, librave, revistave frutat e stinës. Çfarë fruti është ky? Cili frut të pëlqen ty? Vjersha: “Ngjyrat e mollës” Aktivitet krijues: “Krijojmë pemën me mollë”. Fëmijët vendosin/ngjisin në pemën e krijuar paraprakisht nga edukatorët mollët e vizatuara në letër ose topa të kuq. Lojë: Hedhja e topit në kosh.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista</p> 
E Martë	<p>Njohja me perimet.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/demonstron fëmijëve përmes formave plastike, tablove, librave, revistave perimet e stinës. Vjersha: “Karrota” Ngjyrosja: “Perimet”- Fëmijët ngjyrosin format e perimeve të vizatuara më parë nga edukatorët (shoqëruar me numërimin e tyre). Loja: “Tabela e lotos” (specifikisht me figura perimesh dhe frutash, bashkojmë figurat e ngjashme).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista</p>


		Këngë dhe muzikë.	
E Mërkurë	Përgatitja e ushqimeve 	Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/ pyet fëmijët se; -“kush gatuan në shtëpi? ,Po në çerdhe?” Vizitë: Në kuzhinë. Teta kuzhinierja u tregon fëmijëve se çfarë ushqimesh ka përgatitur për atë ditë. Loja: “Frutat dhe perimet/ Bëj sikur gatuan”(me zgjedhje). Përralla: “Lejleku dhe dhelpira”. Këngë lëvizore.	Manuali i Lojrave
E Enjte	Etika e të ngrënit 	Aktivitet : Shtrojmë tavolinën në çerdhe. Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve si shtrohet tavolina? Si të ndihmojmë mamën/ edukatoren në shtrimin e tavolinës? Pse i lajmë duart para dhe pas ushqimit? Vjersha: “Etika e të ngrënit/ Dreka” – (me zgjedhje) Loja: Lojë me ujë dhe miell.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave
E Premte	Përgatitja e ëmbëlsirës	Këngë: “ Një elefant po kolovitet”. Loja: “Numërojmë biskotat/ Brumi për të luajtur (improvizimi përgatitja e kekut) Panairi i frutave dhe ëmbëlsirave: Edukatorët të	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave

		<p>bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë një frut ose një ëmbëlsirë të përgatitur në shtëpi (shoqëruar me numërimin).</p> <p>Bisedë: Edukatore-fëmijë - Edukatorja pyet fëmijët se çfarë ëmbëlsirash pëlqejnë? Çfarë ëmbëlsirash gatuan mami, gjyshja në shtëpi?</p>	
--	--	--	--

Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

Tema e javës: Veshja në vjeshtë



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Veshja e fëmijëve në vjeshtë</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon fëmijëve se si vishemi? Pse veshim bluzë me mëngë të gjata? Pse veshim atlete/ këpucë? Pse vishemi më lehtë në verë dhe pak më trashë në vjeshtë? (Emërtojmë ngjyrat dhe veshjet e fëmijëve në grup).</p> <p>Loja: “Veshja e kukullës”</p> <p>Pazëll: Formimi i pazëllit me format e veshjeve të fëmijëve në vjeshtë.</p> <p>Përralla: “Dhelpra dhe Lejleku”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p> <p>Mjete Didaktike</p>

<p>E Martë</p>	<p>Veshja për vajzat</p> 	<p>Loja: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin veshje për vajzat: fundi/fustani/triko(me copa/ fletë punëdore). Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/demonstron fëmijëve veshjet për vajzat në vjeshtë. Çfarë fustani/ triko/ geta/ streçe ke veshur ti...? Loja: “Veshja e kukullës”(improvizimi i veshjes së kukullës me veshjet e përgatitura nga aktiviteti i mësipërm). Vjersha: “Jam një vajzë simpatike”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Veshja për djemtë</p> 	<p>Vjersha: “Gimi i vogël”. Loja: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin veshje për djemtë: pantallonat/ bluzë/ jelek (me copa/ fletë punëdore). Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja u tregon/demonstron fëmijëve veshjet për djemtë në vjeshtë. Çfarë pantallonash/ bluzë/ atlete ke veshur ti ...? Loja: Krijojmë kullën me kuba/ lego Muzikë dhe këngë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Ekspozita e veshjeve</p>	<p>Loja: Paraqitja në tablo e veshjeve/ paradë me veshje të përgatitura në grup me mjete të riciklueshme (qese, gjethe, gazeta etj) ose të sjella nga vetë fëmijët. Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë veshje të tyre në çerdhe. Vjersha: “Jam një vajzë simpatike” Përralla: “Kësulëkuqja”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Veshjet e ndryshme</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteve të javës</p>	<p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/Gimi i vogël” Përralla: “Rosaku i shëmtuar”. Aktivitet: Bashkojmë të ngjashmet. Kërkojini fëmijëve të bashkojnë figura të ngjashme frutash dhe perimesh/ veshjesh. Loja: Ecja e fëmijëve gjatë litarit.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>